

## Rreth 'Carers Victoria' (Kujdestarët në Viktoria)

'Carers Victoria' është e vetmja organizatë mbarështetërore që ka për qëllim të vetëm trajtimin e kujdestarëve. Roli ynë kryesor është që të përfaqësojmë interesat e kujdestarëve dhe të ndërmjetësojmë në emrin e tyre me të gjitha shkallët e pushtetit dhe shërbimeve. Po ashtu ne japim edhe informacione, ndihma, këshilla dhe edukatë.

### Cili person quhet kujdestar?

Kujdestar quhet një person që kujdeset dhe ndihmon falas një anëtar të familjes ose një mik që vuan nga një paaftësi trupore, nga një sëmundje mendore ose nga një sëmundje kronike. Personi i sëmurë mund të jetë një fëmijë, një prind i moshuar, një mik apo edhe një bashkëshort.

### Çfarë u ofron kujdestarëve 'Carers Victoria'?

#### Këshillime dhe Mbështetje

Këshillimi ka të bëjë me zhvillimin e bisedave me një person që është në gjendje t'ju ndihmojë që të ndryshoni jetën tuaj dhe rolin tuaj si kujdestar. Të kërkuar këshillim nuk është dështim, nuk është pazotësi ose papërshtatshmëri. Ju keni nevojë që të kujdeseni edhe për veten, përndryshe, si do të jeni në gjendje që të kujdeseni për personin tuaj të dashur për të cilin jeni edhe përgjegjës?

Këshillimi zhvillohet në Anglisht si edhe në 39 gjuhë të tjera.

Këshillimi mund të jepet me anë të telefonit dhe në person. Për momentin ky shërbim është falas për të gjithë kujdestarët.

Ndihma mund të merret me anë të dhënies së të dhënave dhe informacionit dhe ndihmës me probleme të veçanta, si për shembull marrjen e 'Carer Payment' (Pagesë Kujdestarie) ose 'Carer Allowance' (Shtesë Kujdestarie).

#### Këto shërbime i japin rëndësi mbajtjes së sekretit për të gjithë kujdestarët. Grupet e mbështetjes për kujdestarët

Shërbimi juaj etno-specifik mund të ketë edhe një grup mbështetjeje për kujdestarët në komunitetin tuaj, ose 'Carers Victoria' mund t'ju ndihmojë që të kontaktoni një grup pranë jush.

Grupet e mbështetjes për kujdestarët u japin një ndihmë të madhe kujdestarëve. Ata janë një vend ku kujdestarët mund të gjejnë mirëkuptim, ku mund të hapen dhe të tregojnë ato që ndodhin në jetën e tyre dhe mund të mësojnë prej njëri tjetrit. Anëtarët e grupit takohen për të gjetur pak pushim dhe çlodhje nga përkujdesja. Si ndihmë për kujdestarët ka edhe aktivitete sociale dhe edukuese. Disa grupe janë të përgjithshme kurse disa të tjera formohen rreth një sëmundjeje të caktuar si për shembull Sëmundja Parkinson, sëmundjet mendore.

### Supporting Family Carers

Carers Victoria, Level 1, 37 Albert Street (PO Box 2204) Footscray VIC 3011  
P 03 9396 9500 F 03 9396 9555 E cav@carersvic.org.au

## Edukata

'Carers Victoria' ofron një program edukimi për të gjithë kujdestarët në të gjithë shtetin. Programet janë krijuar për t'i ardhur në ndihmë kujdestarëve që të kujdesen sa më mirë për vehten e tyre në mënyrë që të ruajnë energjitë dhe për të shijuar edhe jetën e tyre. Në i përgatitim programet tona për të plotësuar nevojat e secilit grup. Në se ju jeni anëtar i një grupi, kërkoni drejtuesit tuaj që të lidhet me 'Carers Victoria' për të krijuar një program.

Ky është një shërbim falas për të gjithë kujdestarët. Në disa rrethana mund të kërkohet pagimi i një tarife.

**Për të gjitha shërbimet tona kontaktoni: Falas 1800 242 636\***

## Shërbimet e Pushimit Rajonal

Çfarë quhet pushim? Pushim prej përkujdesjes – kohë për t'u çlodhur, prehur duke bërë aktivitetet tuaja të preferuara ose duke u takuar me miq. Viktoria ka nëntë shërbime pushimi. Ato mund t'ju ndihmojnë në rast se keni nevojë urgjente për të pushuar, në se ju duhet që shërbimi për t'ju zëvendësuar t'ju vijë në shtëpi ose pushim një ditë, ose në se dëshironi që personi për të cilin kujdeseni të vendoset në qendrat e përkujdesjes.

Qëllimi i pushimit është që t'ju japë juve, kujdestarëve një ekuilibër në jetë. Vërtet, kujdesi për një person tjetër mundëson që ai person të jetë me ju në një shtëpi, me kujdesjen më të mirë, me më shumë intimitet, por në të njëjtën kohë është edhe një punë e lodhshme, me stress dhe që mund të sjellë pasoja për shëndetin në rast se nuk kihet kujdes. Pushimet e rregullta nga përkujdesja mundësojnë një shërbim më të mirë dhe një jetë më të mirë edhe për ju.

**Telefonatë Falas: 1800 052 222\***

*\*Falas përveç telefonatave të bëra nga celularët.*

## Ndihma financiare

### Pagesat e Centrelink për kujdestarët janë:

'**Carer Payment**' është një pagesë që varet nga të ardhurat, dhe pronat dhe i jepet një personi që nuk mund të punojë për shkak se kujdeset për një person tjetër. Kësaj pagese mund t'i bashkangjiten edhe kartat e konçesionit si edhe ndihma me faturën e telefonit apo të qerasë. Pagesë çdo dy-javorëshe.

'**Carer Allowance**' është një pagesë që nuk varet nga të ardhurat dhe jepet me qëllim që të ndihmojë me disa nga shpenzimet që dalin gjatë kujdesjes për një person në shtëpi. Para se të bëhet kërkesa duhet të përgatitet edhe një raport nga mjeku. Pagesë çdo dy-javorëshe.

Telefononi tek 'Carers Victoria' për këshilla për plotësimin e formularëve.

**Centrelink: 13 12 02**